

**L I G J**  
**PËR MENAXHIMIN ME PRONËN E KONFISKUAR, ME PËRFITIMIN**  
**PRONËSOR DHE ME SENDET E KONFISKUARA NË**  
**PROCEDURËN PENALE DHE KUNDËRVAJTËSE**

**I. DISPOZITAT THEMELORE**

**Dispozita e përgjithshme**  
**Neni 1**

Me këtë ligj, rregullohet menaxhimi, shfrytëzimi dhe disponimi me pronën e konfiskuar përkohësisht, me përfitimin pronësor dhe me sendet e konfiskuara përkohësisht, si edhe me pronën e konfiskuar, me përfitimin pronësor dhe me sendet e konfiskuara me vendim të plotfuqishëm në procedurën penale dhe të kundërvajtjes, si edhe themelimi, kompetencat, menaxhimi, udhëheqja dhe çështjet të tjera, që kanë të bëjnë me punën e Agjencisë për menaxhimin me pronën e konfiskuar (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

**Kuptimi i nocioneve në këtë ligj**  
**Neni 2**

Nocionet e caktuara, të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin në vijim:

1. Me nocionin “prona e konfiskuar”, nënkuptohet prona e konfiskuar përkohësisht, përfitimi pronësor dhe sendet e konfiskuara përkohësisht, si edhe prona e konfiskuar, përfitimi pronësor dhe sendet e konfiskuara me vendim të plotfuqishëm, në procedurë penale dhe të kundërvajtjes;

2. Me nocionin “prona e konfiskuar përkohësisht, përfitimi pronësor dhe sendet e konfiskuara”, nënkuptohen prona e cekur, përfitimi pronësor dhe sendet e konfiskuara, për konfiskimin final gjegjësisht për konfiskimin e të cilave, nuk është marrë vendim i plotfuqishëm dhe

3. Me nocionin “prona e konfiskuar, përfitimi pronësor dhe sendet e konfiskuara”, nënkuptohen prona e cekur, përfitimi pronësor dhe sendet e konfiskuara ose të sekuestruara me vendim të plotfuqishëm.

**Parimet e Ligjit**  
**Neni 3**

Gjatë procedimit dhe menaxhimit me pronën e konfiskuar, procedohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të ekonomizimit, të efikasitetit, të transparencës, të procedimit me kujdesin e nikoqirit të mirë, me përgjegjësi, me ekspertizë, me profesionalizëm dhe me azhurnim.

**Informatat e klasifikuara**  
**Neni 4**

Informatat, të cilat gjatë kryerjes së detyrës do t'i kuptojnë të punësuarit në Agjencinë, paraqesin informata të klasifikuara me shkallë përkatëse të fshehtësisë, në përputhje me rregullat për informatat e klasifikuara.

**II. AGJENCIA PËR MENAXHIMIN ME PRONËN E KONFISKUAR**

**Statusi i Agjencisë**  
**Neni 5**

Agjencia, ka cilësinë e personit juridik me të drejta, me obligime dhe me përgjegjësi të përcaktuara me këtë ligj.

Agjencia ka Statut.

Selia e Agjencisë është në Shkup.

Agjencia, për punën e vet përgjigjet para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

### **Fushëveprimi i punës së Agjencisë Neni 6**

Agjencia i kryen punët në vijim:

- menaxhon me pronën e konfiskuar, me përfitimin pronësor dhe me sendet e konfiskuara,

- me pëlqimin e gjykatës dhe të organit kompetent, menaxhon me pronën e konfiskuar përkohësisht dhe me përfitimin pronësor dhe me sendet e konfiskuara përkohësisht, me qëllim që të ruhet vlera e pronës në përputhje me këtë ligj,

- e zbaton procedurën për realizimin e konfiskimit të pronës dhe të përfitimit pronësor,

- e ruan dhe e magazinon pronën e konfiskuar,

- e bën vlerësimin,

- e mban evidencën e pronës së përgjithshme të konfiskuar,

- e shet pronën e konfiskuar,

- e përpilon raportin statistikor, financiar dhe raportet e tjera për pronën e konfiskuar,

- e planifikon, e organizon dhe e zbaton trajnimin për të punësuarit në Agjencinë dhe në subjektet e tjera, të përfshira në procedimin me pronën e konfiskuar,

- jep mendime që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe

- bën punë të tjera, të përcaktuara me ligjin.

Këshilli drejtues i Agjencisë, me akt nënligjor e përcakton mënyrën e mbajtjes së evidencës së të dhënave për pronën e konfiskuar.

### **Nxjerrja e planeve për punë Neni 7**

Më së voni deri më 1 shtator në vitin rrjedhës, Këshilli drejtues i Agjencisë miraton plan për punë dhe plan financiar të reviduar të Agjencisë për vitin e ardhshëm.

### **Edukimi dhe trajnimi i të punësuarve Neni 8**

Të punësuarit në Agjencinë, kanë të drejtë dhe obligim për edukim dhe për trajnim, në përputhje me Programin vjetor dhe me planin vjetor të cilin e miraton Këshilli drejtues i Agjencisë.

### **Legjitimacioni zyrtar Neni 9**

Të punësuarit në Agjencinë, kanë legjitimacion zyrtar të cilin e lëshon dhe e heq drejtori i Agjencisë.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit zyrtar, mënyrën e lëshimit dhe të heqjes së tij, me akt nënligjor i përcakton Këshilli drejtues i Agjencisë.

### **Parashtrimi i Raportit për punë Neni 10**

Agjencia, për punën e vet përpilon raport vjetor dhe raport financiar të reviduar. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni i miraton Këshilli drejtues, pas kësaj parashtrohen pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, më së voni deri më 31 maj të vitit të ardhshëm.

Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni, përmbajnë të dhëna për punën e Agjencisë dhe të dhëna për shfrytëzimin, për menaxhimin dhe për disponimin me pronën e konfiskuar, me përfitimin pronësor dhe me sendet e konfiskuara.

### **Dorëzimi i raporteve pranë gjykatave dhe pranë prokurorisë publike**

#### **Neni 11**

Me kërkesë të gjykatës kompetente ose të organit tjetër kompetent, Agjencia u dërgon raport për procedimin me lëndën konkrete.

Agjencia, dërgon raporte tremujore pranë organeve nga paragrafi 1 i këtij neni, për procedimin me lëndën konkrete për pronën e konfiskuar përkohësisht, për përfitimin pronësor dhe për sendet e konfiskuara përkohësisht.

## **III. ORGANET E MENAXHIMIT DHE TË UDHËHEQJES ME AGJENCINË**

### **Organet e Agjencisë**

#### **Neni 12**

Organet e Agjencisë janë Këshilli drejtues dhe drejtori.

### **Përbërja e Këshillit drejtues**

#### **Neni 13**

Me Agjencinë drejton Këshilli drejtues i cili përbëhet prej pesë anëtarësh edhe atë nga një anëtar me propozim të Ministrisë së Drejtësisë, të Ministrisë së Financave, të Avokaturës Shtetërore, të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe të Këshillit të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë.

### **Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit drejtues**

#### **Neni 14**

Anëtarët e Këshillit drejtues, i emëron dhe i shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë, për periudhë pesëvjeçare, pa të drejtë për rizgjedhje.

Anëtarët e Këshillit drejtues, zgjedhin kryetar nga radhët e vet, në seancën e parë të Këshillit drejtues.

Kur ndonjë anëtar i Këshillit drejtues, do të pushojë ta kryejë detyrën para skadimit të mandatit, në vend të tij emërohet anëtar tjetër deri në skadimin e mandatit të anëtarit i cili zëvendësohet.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, mund ta shkarkojë kryetarin ose anëtarin e Këshillit drejtues para skadimit të mandatit.

- me kërkesë të tij,
- kur i është kumtuar sanksioni i kundërvajtjes, ndalesa për ushtrimin e profesionit, të veprimtarisë ose të detyrës së personit udhëheqës në institucionin,
- për shkak të sëmundjes së rëndë afatgjatë, e cila e pengon në kryerjen e obligimeve,
- nëse e humb aftësinë për punë,
- nëse konstatohet se gjatë kryerjes së funksionit, vetë ose së bashku me anëtar tjetër të Këshillit drejtues, vepron në kundërshtim me qëllimet themelore të ligjit, që mund të vërtetohet nga raporti i revizorit për shkallën e arritjes së kompetencave ligjore të Agjencisë dhe

- për shkak të kryerjes së funksionit të kryetarit ose të anëtarit të Këshillit drejtues, në mënyrë jo eksperte, joprofesionale dhe të pandërgjegjshme, në fushën e punës materiale dhe financiare, të konstatuar në raportin e revizorit.

### **Kompetencat dhe mënyra e punës së Këshillit drejtues të Agjencisë**

#### **Neni 15**

Këshilli drejtues i Agjencisë i kryen punët në vijim:

- e miraton Statutin e Agjencisë, për të cilin pëlqimin e jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë,
- e nxjerr rregulloren për punë,
- e miraton planin vjetor dhe planin e reviduar financiar të Agjencisë,
- e miraton raportin vjetor dhe raportin e reviduar financiar,
- miraton rregulla nënligjore për zbatimin e këtij ligji,
- nxjerr akte për organizimin dhe për sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë dhe
- punë të tjera, të përcaktuara me këtë ligj dhe me Statutin e Agjencisë.

Këshilli drejtues punon dhe vendos në seanca.

### **Drejtori i Agjencisë**

#### **Neni 16**

Me Agjencinë udhëheq drejtori.

Drejtorin e Agjencisë e zgjedh dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

### **Emërimi i drejtorit**

#### **Neni 17**

Për drejtor të Agjencisë mund të emërohet personi i cili i përmbush kushtet në vijim:

- të ketë të kryer së paku arsim sipëror nga sfera drejtësisë ose ekonomisë,
- të ketë së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit, dhe
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.

### **Mandati i Drejtorit**

#### **Neni 18**

Drejtori ka mandat i cili zgjatë pesë vjet.

### **Shkarkimi i drejtorit**

#### **Neni 19**

Drejtori i Agjencisë mund të shkarkohet para skadimit të mandatit në rastin:

- nëse me punën e tij të pandërgjegjshme dhe të parregullt shkakton çrregullim në kryerjen e punëve të Agjencisë dhe shkakton dëm të përcaktuar në procedurë në pajtim me ligjin,
- nëse nuk punon dhe vepron sipas ligjit, Statutit dhe akteve të Agjencisë, ose pa arsye nuk i zbaton vendimet e Këshillit drejtues, ose vepron në kundërshtim me to;
- kur i është kumtuar dënimi ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës së personit përgjegjës në institucion,
- nëse e humb aftësinë për punë,
- nëse nuk dërgon raport në pajtim me nenin 15 të këtij ligji, përkatësisht nëse edhe pas skadimit të afatit të përcaktuar në të njëjtin paragraf nuk i mënjanon mangësitë dhe/ose në këtë afat përsëri ka mangësi dhe/ose humbje në punën financiare, dhe me kërkesën e tij;

## **Punët që i kryen drejtori**

### **Neni 20**

Drejtori i Agjencisë i kryen punët si vijojnë:

- e përfaqëson dhe prezanton Agjencinë,
- e organizon dhe udhëheq me shërbimet profesionale të Agjencisë,
- i zbaton vendimet e Këshillit drejtues,
- përgatit dhe i propozon Këshillit drejtues plan vjetor dhe plan të reviduar financiar,
- përgatit dhe i propozon Këshillit drejtues plan vjetor dhe plan të reviduar financiar,
- përgatit dhe i propozon Këshillit drejtues dispozita nënligjore për zbatimin e këtij ligji,
- propozon dhe i zbaton aktet për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë,
- kujdeset për punën ligjore dhe harxhimin e mjeteve financiare të Agjencisë,
- miraton akte individuale për të punësuarit nga sfera e marrëdhënieve të punës,

dhe

- vendos edhe për çështje të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin e Agjencisë.

Drejtori i Agjencisë është i obliguar që në çdo gjashtë muaj t'i dorëzojë raport pune Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit drejtues të Agjencisë.

## **Autorizimi për kryerjen e punëve**

### **Neni 21**

Drejtori i Agjencisë mund të autorizojë të punësuar në Agjenci që të nënshkruajë akte, të vendosë për çështje të caktuara dhe të kryejë punë të tjera në kompetencë të Agjencisë, përveç për akte dhe punë të cilat janë në pajtim me ligjin janë në kompetencë ekskluzive të drejtorit.

Drejtori i Agjencisë në çdo kohë mund ta tërheqë autorizimin e dhënë nga paragrafi 1 i këtij neni.

Autorizimi i dhënë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e pengon drejtorin t'i kryejë punët.

## **Përcaktimi i organizimit të brendshëm**

### **Neni 22**

Organizimi i brendshëm i Agjencisë përcaktohet në pajtim me fushëveprimin e vet të punës të përcaktuar me ligj.

## **Statuti i Agjencisë**

### **Neni 23**

Agjencia ka Statut me të cilën veçanërisht rregullohen:

- punët nga kompetencat e Agjencisë dhe mënyra e kryerjen së tyre, kompetencat e Këshillit drejtues dhe të drejtorit,
- mënyra zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të Këshillit drejtues,
- të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve, bashkëpunimi ndërkombëtar i Agjencisë, dhe
- çështje të tjera me rëndësi për punën e Agjencisë.

## **IV. MARRËDHËNIET E AGJENCISË ME ORGANET E TJERA**

### **Njoftimi i Agjencisë për pronën e konfiskuar përkohësisht**

#### **Neni 24**

Pas vendimit të marrë të gjykatës ose organit tjetër për konfiskimin e përkohshëm të pronës, përfitimit pronësor ose sendeve, gjykata ose organ tjetër, pa prolongim e njoftojnë Agjencinë.

Prona, përfitimi pronësor dhe sendet nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç atyre për të cilat gjykata vendos ndryshe, i dorëzohen Agjencisë.

Gjatë marrjes së pronës, përfitimit pronësor dhe sendeve nga paragrafi 1 i këtij neni përpilohet procesverbal i cili i përmban të dhëna për llojin, sasinë, gjendjen në të cilën pranohen, personin nga i cili është sekuestruar, si dhe përcaktimin e vlerës së caktuar nga vlerësuesi i autorizuar dhe të dhëna tjera relevante për pronën, përfitimin pronësor dhe sendet e sekuestruara.

Këshilli drejtues me akt nënligjor e përcakton formularin nga paragrafi 3 i këtij neni.

### **Njoftimi i Agjencisë për pronën e konfiskuar me vendim të plotfuqishëm**

#### **Neni 25**

Pas vendimit të marrë të plotfuqishëm të gjykatës ose të organit tjetër me të cilin konfiskohet prona, përfitimi pronësor ose sekuestrohen sende, gjykata përkatësisht organi detyrimisht menjëherë e njofton Agjencinë dhe i dorëzon pronën e konfiskuar, përfitimin pronësor ose sendet nëse paraprakisht nuk i janë dorëzuar Agjencisë.

## **V. VEPRIM ME PRONËN E KONFISKUAR**

### **Veprimi i Agjencisë me pronën e konfiskuar**

#### **Neni 26**

Me pronën e konfiskuar Agjencia vepron në pajtim me parimin e nikoqirit të mirë dhe afaristit të mirë.

Gjatë veprimit me pronën e sekuestruar Agjencia mund të kërkojë kryerjen e punëve të caktuara nga persona të tjerë fizikë dhe juridikë të specializuar për vlerësime për nevojat e vlerësimit të pronës, shitjen e saj dhe ngjashëm

### **Përcaktimi i vlerës së pronës së sekuestruar**

#### **Neni 27**

Gjatë pranimit të pronës, Agjencia bën përcaktimin e vlerës së saj në treg, me ç'rast mund të shfrytëzojë shërbime të vlerësuesve të autorizuar.

Për lartësinë e vlerës së përcaktuar të pronës Agjencia e njofton gjykatën kompetente, Prokurorinë Publike, Avokatin shtetëror, organ tjetër kompetent ose personin nga i cili është konfiskuar prona.

Prokuroria publike, Avokatura Shtetërore ose palë tjetër e prekur mund t'i parashtrijë kundërshtim për vlerën e përcaktuar organit i cili ka marrë vendim për sekuestrimin e pronës.

### **Zbatimi i vendimit të gjykatës ose organit tjetër për sekuestrimin e pronës**

#### **Neni 28**

Vendimin për sekuestrimin e pronës e zbaton Agjencia.

Në zbatimin nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia mund të kërkojë asistencë nga Ministria e punëve të brendshme.

### **Veprimi me sende me rëndësi historike dhe artistike**

#### **Neni 29**

Nëse përkohësisht janë të sekuestruar sende me vlerë të veçantë historike, shkencore ose artistike, Agjencia i dorëzon për ruajtje në institucion përkatës kompetent për ruajtjen e këtij lloji sendesh.

Pas plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin konfiskohen sendet nga paragrafi 1 të këtij neni, pa kompensim, i transferohen institucionit përkatës kompetent për ruajtjen e këtij lloji sendesh, të përcaktuar me ligj të veçantë.

### **Veprimi me gurë të çmuar dhe metale fisnike të sekuestruara Neni 30**

Nëse përkohësisht janë sekuestruar gurë të çmuar dhe metale fisnike, Agjencia deri në vendimin e plotfuqishëm i dorëzon për ruajtje në Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë.

Pas plotfuqishmërisë së vendimit Banka popullore e Republikës së Maqedonisë ia kthen Agjencisë sendet nga paragrafi 1 i këtij neni.

### **Cedimi i pronës së patundshme të konfiskuar Neni 31**

Nëse është konfiskuar pronë e patundshme me vendim të plotfuqishëm, Agjencia e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë e cila mund të marrë vendim për cedimin e pronës së patundshme organit tjetër shtetëror pa kompensim, në pajtim me ligjin.

Për cedimin e pronës së patundshme nga paragrafi 1 i këtij neni Qeveria e Republikës së Maqedonisë vendos në afat prej një muaji nga dita e njoftimit.

### **Ruajtja e pronës së patundshme e konfiskuar përkohësisht Neni 32**

Agjencia i ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pronës së patundshme të konfiskuar përkohësisht.

Shpenzimet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pronës nga paragrafi 1 i këtij neni janë në barë të Agjencisë.

### **Menaxhimi i letrave me vlerë të sekuestruara Neni 33**

Shitja dhe menaxhimi i pasurisë së sekuestruar me vendim të plotfuqishëm që përbëhet prej letrave me vlerë bëhet në pajtim me dispozitat me të cilat është rregulluar qarkullimi i letrave me vlerë.

Administrimin dhe menaxhimin me pasurinë e sekuestruar nga paragrafi 1 i këtij neni e bëjnë bankat dhe institucionet e autorizuara financiare në pajtim me Ligjin për letrat me vlerë.

### **Procedura për shitjen e sendeve të sekuestruara Neni 34**

Shitja e sendeve të sekuestruara bëhet me ankand publik.

Shitja e sendeve të sekuestruara botohet së paku shtatë ditë para mbajtjes së ankandit publik së paku në një gazetë ditore, si dhe në internet faqen e Agjencisë ku do të prezantohet edhe lista me përshkrim detal të sendeve që shiten.

Shitjen e sendeve e realizon komisioni i formuar nga drejtori i Agjencisë.

### **Shitja nën vlerën e çmuar Neni 35**

Sendet e sekuestruara nuk mund të shiten nën vlerën e çmuar në pajtim me nenin 27 të këtij ligji.

Nëse në ankandin e parë nuk është arritur çmimi në lartësinë e vlerës së çmuar, Agjencia do të caktojë ankand të ri në të cilin sendet mund të shiten nën vlerën e çmuar, por jo nën çmimin e vlerësuar të zvogëluar për një të katërtën nga vlera e çmuar.

### **Ofrimi i çmimit dhe marrja e sendeve**

#### **Neni 36**

Blerësi është i detyruar që çmimin ta arkëtojë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe sendet t'i marrë menjëherë pas mbarimit të ankandit.

Blerësi bëhet pronar i sendeve të blera.

Blerësit nuk i takojnë të drejtat në bazë të garancisë, për shkak të mungesës së sendeve.

Blerës nuk mund të jetë personi i dënuar ose personi kundër të cilit është mbajtur procedura penale ose për kundërvajtje, të punësuarit në Agjenci ose personi tjetër i cili zyrtarisht merr pjesë në procedurën për shitje.

### **Shitja e patundshmërisë së konfiskuar**

#### **Neni 37**

Në bazë të aktit për përmbarrim nga gjykata ose nga organi i cili e ka marrë vendimin e plotfuqishëm për konfiskimin e pronës së patundshme, e me propozim të Agjencisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë sjell vendim për shitjen e pronës së sekuestruar të patundshme.

Agjencia, në bazë të vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, miraton konkluzion për shitjen e patundshmërisë me të cilën përcaktohet mënyra dhe kushtet e shitjes, si dhe koha dhe vendi i shitjes.

Konkluzionin për shitje, Agjencia e shpall në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", në së paku një gazetë ditore dhe në internet faqen e Agjencisë.

Shitja realizohet në afat prej 15 deri 30 ditë nga botimi i konkluzionit për shitje në mjetet e informimit publik.

### **Shitja nëpërmjet ankandit publik**

#### **Neni 38**

Shitja e patundshmërisë së konfiskuar bëhet me ankand publik gojor.

Ankandin publik gojor për shitje e realizon komisioni i formuar nga drejtori i Agjencisë.

### **Kushtet për shitje**

#### **Neni 39**

Kushtet për shitje, përveç të dhënave tjera përmbajnë:

- 1) përshkrimin e përafërt të patundshmërisë së sekuestruar,
- 2) personin në dobi të të cilit e drejta ligjore dhe e drejta e regjistruar e gëzimit ose e drejta e regjistruar e banimit të patundshmërisë së konfiskuar, si dhe për uzufruktet e fushës dhe ato shtëpiake.
- 3) vlerën e patundshmërisë të caktuar në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;
- 4) çmimin sipas të cilit patundshmeria mund të shitet;
- 5) afatin në të cilin blerësi është i detyruar ta ofrojë çmimin;
- 6) mënyrën e shitjes;
- 7) shumën e garancisë dhe
- 8) klauzolën se tatimin për qarkullim e paguan blerësi.



Shitja e patundshmërisë me ankand publik bëhet në selinë e Agjencisë.  
Afati gjatë të cilit blerësi është i detyruar ta depozitojë çmimin nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga dita e shitjes.

Me përjashtim, e më pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, afati mund të jetë i vazhduar më së shumti deri tre muaj.

#### **Ofrimi i garancisë Neni 40**

Në ankandin publik mund të marrin pjesë vetëm personat të cilët paraprakisht kanë vënë garancinë.

Garancia është një e dhjeta e vlerës së përcaktuar e patundshmërisë së konfiskuar.

Ofertuesve oferta e të cilëve nuk është pranuar, garancia ju kthehet menjëherë pas mbarimit të ankandit publik.

#### **Përsëritja e ankandit publik Neni 41**

Ankandi publik nuk do të mbahet nëse merr pjesë vetëm një ofertues.

Në rast të paragrafit 1 të këtij neni Agjencia në afat prej 30 ditëve cakton ankand të ri publik.

#### **Subjektet të cilët nuk mund të marrin pjesë në ankandin publik Neni 42**

Blerës nuk mund të jenë të punësuarit në Agjenci ose personat tjerë të cilët zyrtarisht marrin pjesë në procedurën për shitje, si dhe personi i dënuar ose personi kundër të cilit është mbajtur procedura gjyqësore ose për kundërvajtje.

#### **Zbatimi i ankandit Neni 43**

Në ankandin e parë, patundshmëria nuk mund të shitet nën çmimin e përcaktuar, në pajtim me nenin 27 të këtij ligji.

Nëse patundshmëria e konfiskuar nuk mund të shitet në ankandin e parë, Agjencia do të konvokojë ankand të dytë, me çmim fillestar të patundshmërisë së lëndës të zvogëluar për një të katërtën nga vlera e përcaktuar.

Nga ankandi i parë deri në ankandin e dytë, doemos duhet të kalojnë së paku 15 ditë, por jo më shumë se 30 ditë.

Pasi që ta konfirmojë se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e ankandit, kryetari i Komisionit që e realizon ankandin fillon me ankand.

Ankandi përfundon pas kalimit të tre minutave, menjëherë pas deklarimit të ofertës më të volitshme.

Pas ankandit të përfunduar kryetari i Komisionit konstaton se cili ofertues ka ofruar çmim më të mirë, dhe se atij ofertuesi i shitet patundshmëria.

Për shitjen e patundshmërisë, Komisioni përgatit procesverbal dhe miraton konkluzion për shitjen, të cilin e dorëzon te të gjithë pjesëmarrësit a ankandit.

Kundër konkluzionit nga paragrafi 7 të këtij neni, lejohet padi për ngritjen e kontestit administrativ para Gjykatës Administrative, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit.

Padia e paraqitur nuk e ndalon zbatimin e konkluzionit për shitje.

Pas pagesës së çmimit të patundshmërisë, Agjencia në afat prej tri ditësh miraton konkluzion për shitjen e kryer, i cili paraqet bazë juridike për marrjen e së drejtës së pronësisë.

Agjencia do të miratojë konkluzion për shitjen e patundshmërisë, pasi që të konfirmojë se janë plotësuar kushtet për plotfuqishmërinë e shitjes.

Konkluzioni për shitje të patundshmërisë, dorëzohet te të gjithë personat te të cilët dorëzohet konkluzioni për shitjen, te blerësi dhe te të gjithë pjesëmarrësit në ankand, në afat prej tetë ditësh nga miratimi.

### **Depozitimi i çmimit**

#### **Neni 44**

Blerësi është i obliguar që ta depozitojë çmimin në afatin e përcaktuar në nenin 39 të këtij ligji.

Nëse blerësi në afatin e përcaktuar nuk e depoziton çmimin, Agjencia me konkluzion do ta shpallë ankandin të pavlefshëm, dhe të caktojë shitje të re.

Nga garancia e depozituar do të përmbushen shpenzimet e shitjes së re.

### **Dorëzimi në zotërim i patundshmërisë**

#### **Neni 45**

Pas pagesës së çmimit nga ana e blerësit, në afat prej tetë ditësh Agjencia miraton konkluzion për dorëzimin e patundshmërisë në zotërim të blerësit.

Konkluzioni dorëzohet te të gjithë personat te të cilët dorëzohet konkluzioni për shitje të patundshmërisë.

### **Patundshmëritë që nuk janë shitur edhe pas ankandit të dytë**

#### **Neni 46**

Për patundshmëritë që nuk mund të shiten në ankandin e dytë, Agjencia dorëzon propozim te Qeveria e Republikës së Maqedonisë, për shfrytëzimin apo lëshimin e tyre.

### **Shitja e pjesës së sekuestruar**

#### **Neni 47**

Pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm për sekuestrimin e pjesëve, Agjencia do ta regjistrojë pjesën, në Librin e pjesëve dhe Regjistrin tregtar.

Shitja e pjesëve kryhet në pajtim me dispozitat për shitjen e sendeve të tundshme, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### **Shitja e pronës së konfiskuar përkohësisht**

#### **Neni 48**

Agjencia mundet me pajtimin paraprakisht të gjyqit, të miratojë vendim për shitjen e pronës së tundshme të konfiskuar përkohësisht, nëse vlerëson se me ruajtjen e sendit zvogëlohet vlera e tij ose shpenzimet për ruajtjen e tij janë të mëdha në mënyrë joproportionale.

Prona e patundshme e konfiskuar përkohësisht, nuk mund të bëhet lëndë e shitjes.

### **Pagesa e mjeteve nga shitja e sendeve të konfiskuara përkohësisht**

#### **Neni 49**

Mjetet e fituara nga shitja e sendeve të konfiskuara përkohësisht, paguhen në llogarinë e veçantë të hyrjeve të Agjencisë

Nëse miratohet vendim i plotfuqishëm për kthimin e sendit, Agjencia pronarit ia paguan mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Në rast se mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni do të jenë më të vogla se vlera e përcaktuar, dallimi i paguhet pronarit nga mjetet për rezerva të Republikës së Maqedonisë.

### **Shitja e pronës së konfiskuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor**

#### **Neni 50**

Agjencia e shet pronën e patundshme dhe sendet e konfiskuara me vendim të plotfuqishëm, menjëherë pas plotfuqishmërisë së vendimit, ndërsa mjetet e fituara paguhen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

### **Lëshimi i pronës së konfiskuar përkohësisht, organeve shtetërore, shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve**

#### **Neni 51**

Agjencia mundet që sende të caktuara si ushqim, veshje dhe pije joalkoolike t'ua kalojë pa kompensim organeve shtetërore, shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve në pajtim me ligjin, për këtë e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Këshilli drejtues me akt nënligjor e përcakton mënyrën e lëshimit të pronës së konfiskuar përkohësisht, organeve shtetërore, shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve

### **Kalimi i sendeve të konfiskuara me vendim të plotfuqishëm**

#### **Neni 52**

Agjencia mund t'ua lëshojë sendet e konfiskuara me vendim të plotfuqishëm, organeve të tjera shtetërore, pas pajtimit paraprakisht të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

### **Financimi dhe mjetet e punës**

#### **Neni 53**

Mjetet e punës së Agjencisë, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

## **VI. PROCEDIMI ME SENDET JASHTË QARKULLIMIT**

### **Procedimi me drogat e konfiskuara narkotike, substancat psikotropike dhe prekursorët**

#### **Neni 54**

Drogat e konfiskuara narkotike, substancat psikotropike dhe prekursorët dorëzohen për ruajtje në Agjenci. Nëse në Agjenci nuk ekzistojnë kushte për ruajtje të drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve, ato ruhen te organi kompetent shtetëror, që i plotëson kushtet e përcaktuara për ruajtjen e tyre. Gjatë dorëzimit përpilohet procesverbal.

Drogat e konfiskuara narkotike, substancat psikotropike dhe prekursorët, ruhen në lokal të veçantë.

Shpenzimet për ruajtje, shitje dhe shkatërrim të drogave të konfiskuara narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve, i mbart Agjencia.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me dekret i rregullon standardet për sigurinë dhe mënyrën e ruajtjes, shitjes, shkatërrimit të drogave të konfiskuara narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve, si dhe procedurën për lëshimin e tyre për qëllime shkencore kërkimore.

Këshilli drejtues me akt nënligjor e përcakton formularin e procesverbalit nga paragrafi 1 i këtij neni.

## **Shitja e drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve**

### **Neni 55**

Me vendimin e gjykatës drogat narkotike, substancat psikotropike dhe prekursorët e konfiskuar në procedurë të përcaktuar me këtë ligj, mund tu shiten shoqërive tregtare me leje të veçantë të organit kompetent për qarkullimin dhe prodhimin e ilaçeve.

Gjatë formimit të komisionit për shitjen e drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve drejtori i Agjencisë në Komision emëron anëtar nga Byroja e ilaçeve në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

## **Kalimi i drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve për kërkime shkencore**

### **Neni 56**

Për shkak të nevojave për edukim dhe aftësim gjykata mund të marrë vendim që një ekzemplar nga drogat narkotike, substancat psikotropike dhe prekursorët e konfiskuar t'i kalohet institucionit përkatës i cili bën kërkime shkencore.

## **Asgjësimi i drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve**

### **Neni 57**

Vendim për asgjësimin drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve të konfiskuar merr gjykata kompetente.

Drogat narkotike, substancat psikotropike dhe prekursorët e konfiskuar i asgjëson Komisioni i formuar nga ministri i Drejtësisë.

Komisioni nga paragrafi 2 i këtij neni përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët janë përfaqësues të gjykatës, Prokurorisë Publike, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Agjencisë.

Asgjësimi i drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve të konfiskuar realizohet me djegie në objekt i cili ka licencë për djegie të materieve të rrezikshme.

Për asgjësimin e realizuar komisioni e njofton gjykatën kompetente e cila e ka marrë vendimin për asgjësim.

## **Veprimi me armët, municionin dhe materialin plasës të konfiskuar**

### **Neni 58**

Armët, municioni dhe materiali plasës të konfiskuar në procedurë penale ose për kundërvajtje i dorëzohen Agjencisë. Nëse Agjencia nuk ka kushte për ruajtjen e tyre, ruhen në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Ministrinë e Mbrojtjes.

Armët, municioni dhe materiali plasës furnizimi me të cilat është i ndaluar me ligj, asgjësohen nga Komisioni i nenit 57 të këtij ligji, në objekt i cili posedon kushte përkatëse për këtë dedikim.

Armët që janë në rregull, në përputhje me këtë ligj, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, mund t'i kalojnë pa kompensim policisë gjyqësore, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Armatës së Republikës së Maqedonisë, Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, Policisë Financiare dhe organeve të tjera të cilat me ligj kanë të drejtë të shfrytëzojnë armë.

Armët që janë në rregull, municioni dhe materiali plasës në përputhje me ligj mund të shiten përmes ankandit publik në procedurë të paraparë me këtë ligj, personave juridikë që merren me qarkullimin e armëve dhe municionit dhe personave fizikë të cilët kanë leje për furnizim me armë.

## **Asgjësimi i pronës tjetër të konfiskuar**

### **Neni 59**

Prona tjetër e konfiskuar e cila nuk mund të shitet për shkak të shkaqeve shëndetësore, veterinare, fitosanitare, të sigurisë dhe për shkaqe tjera, asgjësohet nga Komisioni i nenit 57 të këtij ligji.

Produktet e konfiskuara nga duhani, alkooli dhe produktet e tjera për të cilat nuk ekziston deklaratë ose nëse janë false, detyrimisht asgjësohen.

## **VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 60**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e emëron Këshillin drejtues dhe drejtorin e Agjencisë.

### **Neni 61**

Aktet nënligjore miratimi i të cilave është paraparë me dispozitat e këtij ligji, do të miratohen brenda afatit prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 62**

Në afat prej gjashtë muajsh nga dita e fillimit me punë të Agjencisë, gjykatat dhe organet e tjera e njoftojnë për pronën përkohësisht të konfiskuar.

Në afat prej gjashtë muajsh nga dita e fillimit me punë të Agjencisë, gjykatat dhe organet e tjera e njoftojnë për pronën e konfiskuar me vendim të plotfuqishëm e cila nuk është shitur ose nuk ka kaluar dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji ia dorëzojnë për menaxhim Agjencisë.

### **Neni 63**

Dispozitat e ligjeve të tjerë dhe aktet nënligjore që e rregullojnë materien e menaxhimit të pronës së konfiskuar, përfitimit pronësor dhe me sende të konfiskuara në procedurë penale dhe për kundërvajtje, do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji, përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2008.

### **Neni 64**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërkaq zbatimi i tij do të fillojë nga 1 janari i vitit 2009.